



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 146 Akti

Nr. 194 Vendimi

Tiranë, më 6.9.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisioni të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Suela Zhegu	Kryesuese
Xhensila Pine	Anëtare
Etleda Çiftja	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, në datën 4 shtator 2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, kati I, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Enkel Peza**, ndihmësligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës** së Republikës së Shqipërisë dhe neni Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit, z. Enkel Peza, vëzhguesin ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Z. Enkel Peza është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si këshilltar ligjor pranë Gjykatës së Lartë. Bazuar në pikën 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime, në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), specifikon se: *“Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme do të rivlerësohen, ex officio”.*

2. Në bazë të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, z. Enkel Peza, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.5.2018, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët:

Suela Zhegu
Xhensila Pine
Olsi Komici

3. Komisioner Olsi Komici kërkoi përjashtimin nga shqyrtimi i çështjes. Një trup tjetër gjykues, me vendimin e datës 5.5.2019, vendosi pranimin e kërkesës së komisioner Olsi Komicit, duke u zëvendësuar me komisioneren Etleda Çiftja. Së bashku me shortimin e trupit gjykues fillestar është shortuar edhe zëvendësuesi, në rast konflikti interesi. Subjekti i rivlerësimit është njoftuar me *e-mail* të datës 27.3.2019 për këtë zëvendësim.

4. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016; nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe nga Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016.

5. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin nr. 1, datë 17.5.2019, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të

hartuara nga institucionet shtetërore vendosi të fillojë hetim administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktoj kryesues të trupit gjykues, komisionere Suela Zhegu. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Me vendimin nr. 2 datë 30.7.2019, trupi gjykues me shumicë votash vendosi të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Enkel Peza, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes. Referuar provave të administruara nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit Enkel Peza, me detyrë ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Parë, Tiranë. Anëtarja në pakicë Xhensila Pine kërkoi që të mos mbyllej hetimi administrativ, për shkak se shkresat e administruara nga DRT Durrës dhe ato të administruara nga Drejtoria e Tatim Taksave pranë Bashkisë Kavajë kundërshtojnë njëra - tjetrën, dhe për këtë arsye hetimi administrativ duhej të mos mbyllej, por të vijojë me verifikimin dhe qartësimin e mospërputhjeve të mësipërme duke propozuar dërgimin e të dy korrespondencave në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për t'u marrë një qëndrim nga ky organ. Kjo kërkesë u rrëzua me shumicë votash nga anëtarët e trupit gjykues me argumentin se përgjigjet nga Drejtoria Rajonale Durrës me anë të shkresave të cituara më lart dhe shkresave të administruara nga zyra e tatim taksave pranë Bashkisë Kavajë, jo vetëm që nuk kundërshtojnë njëra - tjetrën por e plotësojnë hetimin në lidhje me të ardhurat e subjektit të rivlerësimit. Më tej, çdo përgjigje e administruar nga Drejtoria e Tatimeve Rajonale Durrës ka ardhur si rezultat i një kërkesë nga Komisioni, kërkesa të cilat duken qartë se nuk janë të njëjta për të dyja institucionet. DRT Durrës ka konfirmuar nëse ka të dhëna tatimore për subjektin e rivlerësimit gjatë viteve 2009 - 2011 sipas kërkesës së Komisionit, ndërkohë që Drejtoria e Tatim taksave pranë Bashkisë Kavajë ka informuar mbi qarkullimin faktik nga aktiviteti si avokat gjatë viteve 2009 - 2011, sipas kërkesës së Komisionit. Arsye tjetër se përse nuk ka mospërputhje është fakti se DRT Durrës sipas ligjit administron taksat në nivel kombëtar siç dhe janë sigurimet shoqërore, dhe nga Prilli i vitit 2011 administron personat fizik të cilët kishin detyrimin ligjor të regjistroheshin për efekt Tatimi mbi Vlerën e Shtuar. Ndërkohë që sipas ligjit "Për Taksat Vendore", është Bashkia Kavajë institucioni shtetëror që administron taksat dhe tatimet mbi biznesin e vogël. Për shkaqet e paraqitura më lart, shumica e trupit gjykues, vlerësoi se nuk ka nevojë për hetime të mëtejshme në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti si avokat, pasi shkresat e ardhurat nga DRT Durrës dhe Drejtoria e Tatim taksave pranë Bashkisë Kavajë, nuk kundërshtojnë njëra tjetrën por ato e plotësojnë hetimin.

7. Në datën 30.7.2019, trupi gjykues me anë të postës elektronike njoftoi subjektin e rivlerësimit për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 15 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 – 47 dhe 35 – 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

8. Në datën 21.8.2019 subjekti i rivlerësimit dërgoi në Komision shpjegimet dhe provat pranë zyrës së protokollit.

9. Në datën 30.8.2019, me anë të vendimit nr. 3, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Enkel Peza, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 4.9.2019, ora 9:30, në Pallatin e Koncerteve, kati I, Tiranë.

10. Bazuar në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Enkel Peza, bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. SEANCA DËGJIMORE

11. Në datën 4.9.2019 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016 dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kijlstra. Në seancën dëgjimore subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë personalisht.

12. Seanca dëgjimore e datës 4.9.2019 u ndërpre për të rifilluar në datën 6.9.2019 për shpalljen e vendimit. Në përfundim të seancës dëgjimore subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

13. Subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.

15. Sipas kreve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”:

- i. ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror;
- ii. DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit;
- iii. Inspektorati pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor ka qenë organi përkatës i vlerësimit profesional, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, organ i cili, në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe

të pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar;

- iv. Shkolla e Magjistraturës ka informuar Komisionin mbi rezultatet e testimi pranë Shkollës së Magjistraturës, ku konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka marrë mbi 60 pikë.

16. Megjithëse sa më lart, referuar vendimit nr. 2/2017¹ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

V. RIVLERËSIMI I PASURISË

V/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

17. Me shkresën nr. ***, datë 4.4.2018, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza, i cili është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2017 me numër indeksi *** dhe në bazë të ligjit nr. 76/2016, dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar në datën 27.1.2017, “Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”.

18. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personave të lidhur, është konstatuar:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

V/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

19. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (ç) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të

¹ Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

komunikimit elektronik; (d) provat dhe shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit; dhe (dh) deklaratimet në seancë dëgjimore.

20. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, si dhe të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi: (i) në verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme, apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar

21. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si më poshtë vijon:

Z. A.P. (babai i subjektit) dhe znj. H.P. (nëna e subjektit), për shkak të:

- i. Kontributit të të ardhurave të babait të subjektit që kanë shërbyer për blerjen e automjetit tip “Mercedes Benz” në vitin 2006 – deklaruar në deklaratën “Vetting”, në kohën kur subjekti ishte student.
- ii. Kontributit të të ardhurave të babait të subjektit që kanë shërbyer për shpenzime jetese dhe të tjera gjatë kohës që subjekti i rivlerësimit ka jetuar bashkë me familjen, para deklaratimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.
- iii. Pronar i apartamentit të ndodhur në Rr. “****”, Tiranë, apartament të cilin subjekti i rivlerësimit e ka përdorur gjatë periudhës së studimit, por jo vetëm.
- iv. Bashkëjetesës me prindërit në banesën e ndodhur në lagjen nr. ***, pranë ish-Fabrikës së ***, Kavajë, banesë e cila deri në deklaratën “Vetting” ka qenë në pronësi të z. A.P.

22. Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në “Deklaratën e Pasurisë për Rivlerësimin Kalimtar, Vetting” të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:

1. Automjet, tip “Mercedes-Benz” - targa ***

Faktet nga hetimi administrativ

1.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti ka deklaruar se ka në pronësi automjetin tip “Mercedes Benz”, prodhimi i vitit 1993, i blerë në vitin 2006, kur subjekti ishte student.

Vlera e automjetit: (300,000 lekë + 476,557 lekë dogana), totali 776,557 lekë.

Pjesa takuese: 100%.

Viti	Dokumenti vërtetues	Qarkullim nga aktiviteti i babait të subjektit si avokat
1992	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	66,000
1993	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	105,550
1994	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	150,000
1995	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	421,000
1996	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	1,264,705
1997	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	1,764,706
1998	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	656,200
1999	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	868,000
2000	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	795,000
2001	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	590,200
2002	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	1,046,000
2003	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	1,500,000
2004	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	4,411,764
2005	Nuk ka dokumentacion në arkivë	-
2006	DRT Durrës, bazuar mbi kërkimin manual të Agjencisë Tatimore Kavajë	8,333,334
2007	Bashkia Kavajë	4,820,000
2008	Bashkia Kavajë	5,600,000
2009	Bashkia Kavajë	4,005,000
2010	Bashkia Kavajë	5,070,000
2011	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	644,167
2012	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	710,835
2013	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	809,167
2014	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	941,668
2015	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	1,243,924
2016	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	449,997
	Total	46,267,217

Qarkullimin nga aktiviteti në tregti, i regjistruar me NIPT ***:

Viti	Dokumenti vërtetues	Qarkullim nga aktiviteti i babait të subjektit në tregti
2003	DRT Durrës, sistemi tatimor c@ts	800,000
2004	DRT Durrës, bazuar mbi dokumentacionin e Agjencisë Tatimore Kavajë (kërkim manual)	1,764,705
2005		-
2006		-
2007	Bashkia Kavajë	2,750,000
2008	Bashkia Kavajë	3,100,000
2009	Bashkia Kavajë	3,170,000
2010	Bashkia Kavajë	3,030,000
2011	Bashkia Kavajë	3,092,400
	Total	17,707,105

1.6 Më tej, subjekti i rivlerësimit gjatë përgjigjeve të pyetjeve me anë të postës elektronike, ka deklaruar se përveç të ardhurave si avokat nga viti 2003 e në vazhdim, si burim krijimi kanë shërbyer edhe të ardhura të tjera të përfituara nga shitja e pasurive të paluajtshme dhe e

automjeteve nga viti 1995 deri në vitin 2006, vlera totale e pasurive të shitura deri në vitin 2006 para blerjes së mjetit është 4,280,000 lekë, dhe për të vërtetuar këto të ardhura subjekti paraqiti si provë: (i) kontratë shitblerjeje⁶ ku z. A.P., është me cilësinë e blerësit së apartamentit në Lushnjë, të cilin e ka blerë në vitin 1995 në vlerën 2,580 lekë dhe e ka shitur në vitin 1996 në vlerën 1,050,000 lekë në datën 9.8.1996; (ii) kontratë shitblerjeje⁷ ku z. A.P., është me cilësinë e blerësit të pasurisë së paluajtshme, magazinë, të cilën e ka blerë në vlerën 800,000 lekë në vitin 1996 dhe e ka shitur në vlerën 2,000,000 lekë në datën 25.9.2005; (iii) kontratë shitblerjeje automjeti, nr. ***, datë 16.6.2005, në vlerën 700,000 lekë; (iv) kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 10.5.2006, në vlerën 300,000 lekë; kontratë shitblerjeje automjeti, nr. ***, datë 16.6.2005, në vlerën 700,000 lekë; (v) kontratë shitblerjeje automjeti, nr. ***, datë 10.5.2006, në vlerën 300,000 lekë.

1.7 Personi tjetër i lidhur ka depozituar në Komision dokumentacion provues në lidhje me të ardhurat e tij me vërtetimin nr. ***, datë 23.8.2018, të Dhomës Kombëtare të Avokatisë, nga ku rezulton se z. A.P. është avokat nga viti 1993 dhe në vazhdim dhe nuk ka detyrime, masa dhe procedime disiplinore.⁸

1.8 Në lidhje me mundësitë financiare për blerjen e këtij automjeti nga babai të subjekti të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare duke llogaritur të ardhurat e familjarëve të subjektit të rivlerësimit dhe të ardhurat neto nga personit tjetër lidhur, z. A.P., nga ku rezultoi se personi tjetër i lidhur, z. A.P. ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e këtij automjeti të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017.

1.9 Për më tepër, në lidhje me të ardhurat e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë kontribuar në blerjen e pasurive në përdorim të subjektit të rivlerësimit, referohuni në analizën financiare, sipas tabelës më poshtë:

⁶ Kontratë shitblerjeje nr. *** rep., datë 30.3.1996, me shitës Komisioni i Privatizimit i rrethit Lushnje dhe blerës z. A.P., për objektin me sip. 73 m², me çmim 2,580 lekë.

⁷ Kontratë shitblerjeje objekti nr. ***, datë 16.4.1996, me shitës N.H. dhe blerës A.P. dhe L.L., blerë me çmimin 800,000 lekë secili.

⁸ Vërtetim datë 10.1.2019, i ADISA; librezë pune; vendim nr. ***, datë 3.10.1991; vërtetim datë 25.2.1992; shkresa kthim përgjigje nr. ***, datë 20.8.2018 e DRT-së Durrës; vërtetim nr. ***, ***, datë 23.8.2018, DTTV Bashkia Kavajë; vërtetim nr. ***, datë 27.8.2018, ASHL Kavajë - DRSSH; vërtetim nr. ***, datë 23.8.2018, DHKA Tiranë.

Viti	Aktiviteti i babait				Të ardhura të tjera nga shitblerjeje pasurish	Paga, M.P.	Paga, M.P.	Paga, H.P.	Totali i të ardhurave për çdo vit
	Qarkullim nga aktiviteti si avokat	Fitim <i>neto</i>	Qarkullim nga aktiviteti tregtar	Fitim <i>neto</i>					
1992	66,000	44,220		-				44,220	
1993	105,550	70,719		-				70,719	
1994	150,000	100,500		-				100,500	
1995	421,000	282,070		-	227,420			509,490	
1996	1,264,705	847,352		-	250,000			1,097,352	
1997	1,764,706	1,182,353		-				1,182,353	
1998	656,200	439,654		-				439,654	
1999	868,000	581,560		-				581,560	
2000	795,000	532,650		-				532,650	
2001	590,200	395,434		-				395,434	
2002	1,046,000	700,820		-				700,820	
2003	1,500,000	1,005,000	800,000	120,000				1,125,000	
2004	4,411,764	2,955,882	1,764,705	264,706	-250,000			2,970,588	
2005	-	-	-	-	2,000,000			2,000,000	
2006	8,333,334	5,583,334		-	-			5,583,334	
2007	4,820,000	3,229,400	2,750,000	412,500				3,641,900	
2008	5,600,000	3,752,000	3,100,000	465,000				4,217,000	
2009	4,005,000	2,683,350	3,170,000	475,500		-	-	3,158,850	
2010	5,070,000	3,396,900	3,030,000	454,500		-	-	3,851,400	
2011	644,167	431,592	3,092,400	463,860		115,564	-	1,011,016	
2012	710,835	476,259				499,360	-	975,619	
2013	809,167	324,236				526,505	-	850,741	
2014	941,668	588,365				565,750	208,951	1,363,066	
2015	1,243,924	676,984				704,299	-	1,381,283	
2016	449,997	5,309				818,749	52,597	876,655	
	46,267,217	30,285,943	17,707,105	2,656,066	2,297,420	3,230,227	261,548	-	38,731,204

Tabela: Të ardhurat e personave të tjerë të lidhur të subjektit Enkel Peza

1.10 Pavarësisht analizës financiare, Komisioni në rezultatet e hetimit kryesisht i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me çmimin e blerjes së këtij automjeti, duke hedhur dyshime se çmimi prej 300,000 lekësh, deklaruar për blerjen e tij, është shumë më i lirë nëse i referohemi çmimit të paguar për zhdoganimin e këtij automjeti në shumën 476,557 lekë.

1.11 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare, si dhe gjatë seancës dëgjimore shpjegoi se nga dokumentacioni i DPSHTRR-së konstatohet se shitësi e ka blerë këtë automjet me çmimin 1,000 euro (ose 130,000 lekë -140,000 lekë), dhe ia ka shitur subjektit në shumën 300,000 lekë, pra, rezulton dyfish më shtrenjtë se blerësi i mëparshëm, fakt ky që nuk lë hapësirë për të krijuar dyshime në lidhje me çmimin real të paguar, për më tepër subjekti nuk ka pasur arsye të mos deklarojë çmimin real pasi në atë periudhë nuk ka qenë subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së.

1.12 Komisioni, referuar provave të administruara gjatë hetimit, atyre të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, si dhe shpjegimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm se ai e kishte blerë këtë automjet për një çmim të arsyeshëm, duke qenë se provoi që blerësi i parë kishte paguar 1,000 euro, ndërkohë që e ka blerë për një shumë prej 300,000 lekësh.

1.13 Si konkluzion, në lidhje me automjetin tip “Mercedes Benz”, Komisioni arrin përfundimin se subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar saktë pasurinë në pronësi, ka burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti dhe nuk ka kryer deklarim të rremë.

2. Automjet tip “Mercedes-Benz”, viti prodhimit 1999, blerë në vitin 2013 dhe automjet tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 1999, blerë në vitin 2014

Faktet nga hetimit administrativ

2.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi automjetin tip “Mercedes Benz”, viti i prodhimit 1999, blerë në vitin 2013.

Pjesa takuese: 100 %. Vlera: 110,000 lekë.

Subjekti deklaroi edhe blerjen e një automjeti tjetër tip “Mercedes Benz”, me vit prodhimi 1999, blerë në vitin 2014, në shumën 2,500 euro.

2.2 Si burim të ardhurash, subjekti ka deklaruar për të dy automjetet të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit. Bashkëlidhur subjekti ka dërguar dokumentacion justifikues.⁹

2.3 Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht, konstatoi se ky automjet ishte blerë me kontratën nr. ***, datë 28.8.2013, për blerje automjeti tip “Mercedes Benz” me nr. shasje ***, me vlerë 110.000 lekë, me palë shitëse E.C. dhe palë blerëse Enkel Peza, me leje qarkullimi,

⁹ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. *** kol., datë 28.8.2013, për blerje mjeti tip “Mercedes Benz”, me nr. shasje ***, me vlerë 110,000 lekë. Palë shitëse E.C. dhe palë blerëse Enkel Peza; leje qarkullimi datë 20.3.2008, e mjetit tip “Mercedes Benz”, me nr. shasje ***, me targa ***, në emër të z. E.C.

datë 20.3.2008, për mjetin “Mercedes Benz” me nr. shasie *** me targa ***, në emër të z. E.C.¹⁰ Notere A.Sh.¹¹ ka dërguar kontratën e shitblerjes¹² së automjetit në Komision.

2.4 Në DPSHTRR ky automjet ka figuruar deri në vitin 2017 në emër të shitësit E.C. Në lidhje me këtë fakt është pyetur subjekti i rivlerësimit, i cili është përgjigjur: *“Ky automjet i blerë në datën 28.8.2018 nuk është regjistruar në kohë për shkak se kur unë po merresha me plotësimin e dokumentacionit të plotë për të qarkulluar (pagesën e taksave të prapambetura nga shitësi nga viti 2011 dhe më pas ndërrimin e pronësisë), mjete është përplasur i parkuar në lagjen “***”, Tiranë, në shtator të vitit 2013 nga një automjet tjetër i cili nuk u identifikua asnjëherë dhe pas njoftimit të bërë në organet e rendit, për shkak të aksidentit, mjete ishte jashtë funksionit dhe nuk mund të dërgohej pranë DPSHTRR-së për bërjen e kontrollit fizik dhe ndërrimit të pronësisë. Në shtator – tetor 2017, ky mjet është riparuar (vlera e të cilit është afërsisht 30,000 lekë) janë paguar të plota detyrimet e prapambetura, polica e sigurimit për vitin 2017–2018 dhe taksat për ndërrimin e pronësisë në vlerë afërsisht 90,000 lekë.”*

2.5 Nga verifikimet në faqen zyrtare të AMF-së, www.amf.al, në lidhje me policën e sigurimit të mjetit me targa ***, ka rezultuar se: (i) për periudhën 2010 – 2011 kjo policë rezulton në emër ish-pronarit, z. E.C., në vlerën 14,600 lekë; (ii) për periudhën 2013 – 2014 kjo policë rezulton në emër të z. Enkel Peza, me cilësinë e pronarit, në shumën 7500 lekë; (iii) për periudhën 9.10.2017 – 8.10.2018 kjo policë rezulton në emër të z. E.C. (me shënimin pronar) dhe z. Enkel Peza (me shënimin përdorues), në shumën 18,972 lekë. Gjithashtu, në dokumentet e sjella nga drejtoria e targave, në pikën 11 referohet një pagesë e kryer në datën 25.2.2014, e cila mungon në dosje.

2.6 Referuar fakteve të përmendura më lart, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me: (i) mospërputhje të deklaramit të subjektit me dokumentacionin e administruar nga DPSHTRR, duke qenë se subjekti i rivlerësimit ka vërtetuar deklaramin e tij mbi pronësinë e makinës me kontratën shitjes së datës 28.8.2013, por jo në regjistrimin e tij te DPSHTRR, pasi rezulton se ky automjet nuk është regjistruar sipas ligjit, ndërkohë që subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se u bë pronar i këtij automjeti në vitin 2017, por nga të dhënat e AMF-së rezulton se subjekti ishte pronar në vitin 2013 – 2014; (ii) dokumentacionin shoqërues që vërteton deklaramin e tij në lidhje me arsyet se përse nuk e ka regjistruar pronësinë e automjetit në DPSHTRR; (iii) faktin se nuk është e qartë për Komisionin pagesa që ka kryer subjekti në datën 25.2.2014, e dhënë e cila u konstatua nga dosja e dërguar nga DPSHTRR-ja.

2.7 Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet përfundimtare, si dhe gjatë seancës dëgjimore pranoi se ka depozituar me vonesë kontratën në DPSHTRR, por shpjegoi se sipas ligjit regjistrimi me vonesë i nënshtrohet penaliteteve. Më tej, subjekti shpjegoi se regjistrimi me vonesë është bërë për shkak të një aksidenti, i cili ka dëmtuar mjetin në fjalë që pa u riparuar nuk mund t'i nënshtrohej procedurave të regjistrimit në DPSHTRR.

2.8 Komisioni, referuar provave të administruara gjatë hetimit, atyre të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, si dhe shpjegimeve të subjektit gjatë

¹¹ Shkresa *** prot., datë 4.7.2018, drejtuar noter A.Sh.

¹² Kontrata nr. ***, datë 28.8.2013.

seancës dëgjimore, vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm mospërputhjet që ekzistonin në lidhje me kohën kur ishte bërë pronar i këtij automjeti, si dhe provoi me dokumentacion ligjor se ky automjet kishte qenë për riparim, duke qenë se kishte bërë aksident.

3. Automjet tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 1999, blerë në vitin 2014, me targa ***

Faktet nga hetimit administrativ

Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi një automjet tip “Mercedes Benz”, viti 1999, blerë në vitin 2014.

Pjesa takuese: 100 %. Vlera: 2,500 euro.

3.1 Subjekti, si burim krijimi, deklaron të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit avokat, si dhe ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor justifikues.¹³

3.2 **Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht, konstatoi se subjekti i rivlerësimit kishte të regjistruar në DPSHTRR automjetin tip “Mercedes-Benz”, S500, viti i prodhimit 1999, me targa ***, me shitës A.N., me çmimin 2,500 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale, vërtetuar kjo me shkresën me nr. *** prot., datë 4.7.2018, nga DPSHTRR-ja Tiranë.**

3.3 Referuar fakteve të përmendura më lart, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me dyshimet se subjekti e ka blerë më lirë këtë automjet, duke iu referuar çmimit të paguar për doganën e këtij automjeti.

3.4 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet përfundimtare dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi se automjeti është blerë jo më lirë, por mbi katër herë më shtrenjtë se vlera e paguar e doganës për këtë automjet, e cila rezulton të jetë 74,228 lekë. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar shpjegimet e tij, paraqiti dokumentacion ligjor provues, mandatpagesën e deklaratës doganore me nr. ***, datë 20.7.2013¹⁴.

3.5 Komisioni, referuar provave të administruara gjatë hetimit, atyre të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, si dhe shpjegimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, vlerëson se subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor justifikues se çmimi i blerjes së këtij automjeti është më i shtrenjtë, nëse marrim në konsideratë çmimin e paguar për doganën e këtij automjeti.

3.6 Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ky automjet është blerë përpara fillimit të detyrës si ndihmësligjor prej tij dhe se në këtë kohë subjekti nuk ka qenë subjekt deklarimi në ILDKPKI, sipas ligjit, Komisioni çmon se ky pretendim nuk qëndron, pasi çdo pasuri që është objekt deklarimi në deklaratën e pasurisë “Vetting”, i nënshtrohet kontrollit të plotë mbi vërtetësinë, saktësinë e deklarimit dhe ligjshmërinë e burimeve të krijimit, pa asnjë dallim dhe kufizim, i artikuluar ky sipas kriterit të kohës së krijimit apo çdo lloj kriteri tjetër përcaktues. Nuk parashikohet ndonjë normë juridike, sipas së cilës të vendosen kritere vlerësimi, lidhur me pasuritë e subjekteve dhe personave të lidhur, me qëllim përfshirjen apo

¹³ Kontratë shitblerjeje automjeti me nr. ***, datë 25.2.2014, për blerje mjeti tip “Mercedes Benz” S500, me nr. shasie ***, me vlerë 2,500 euro. Palë shitëse A.Gj. dhe palë blerëse Enkel Peza; certifikata e pronësisë datë 13.1.2015, e mjetit tip “Mercedes Benz” S500, me nr. shasie ***, me targa ***, në emër të z. Enkel Peza.

¹⁴ Mandatpagesa e deklaratës doganore (IM4) nr. ***, datë 20.7.2013.

përrjashtimin e tyre nga objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit, sipas nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016.

3.7 **Si konkluzion**, në lidhje me këtë automjet, Komisioni arrin përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë në pronësi, ka burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti dhe nuk ka kryer deklarim të rremë.

4. Automjet tip “BMW”, viti i prodhimit 2002, blerë në vitin 2016, me targa ***

Faktet nga hetimit administrativ

4.1 **Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar** se ka në pronësi automjetin tip “BMW”, me vit prodhimi 2002, blerë në vitin 2016.

Pjesa takuese: 100 %. Vlera: 3,500 euro.

4.2 **Subjekti, si burim krijimi, deklaron** të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit avokat, paga e inspektorit pranë INUK-ut dhe paga e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion ligjor justifikues.¹⁵

4.3 **Komisioni, nga hetimi administrativ kryesisht, konstatoi** se në pronësi të subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza, është automjeti tip “BMW”, GL41, benzinë-gaz, viti i prodhimit 2002. Në dokumentacionin që ndodhet në dosje rezulton edhe kontrata e shitblerjes së automjetit, datë 20.10.2016, me shitës E.N., me çmimin 3,500 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale, vërtetuar me shkresën me nr. *** prot., datë 4.7.2018, nga DPSHTRR-ja.

4.4 Referuar fakteve të përmendura më lart, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit në lidhje me dyshimet se subjekti i rivlerësimit e ka blerë më lirë këtë automjet, duke iu referuar çmimit të shitjes së këtij automjeti në treg.

4.5 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet përfundimtare dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi se ky automjet është prodhuar në vitin 2002, pra, me vjetërsi 17 vjeçare, dhe si i tillë nuk lejohet as të zhdoganohet në Shqipëri, referuar VKM-së nr. ***, datë 26.10.2018, i ndryshuar. Për këtë arsye, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se dyshimi i Komisionit është i pabazuar, sepse ky automjet sot mund të shitet në vlerën prej 8,800 euro. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se edhe nëse i referohemi faqes europiane të shitjes së automjeteve, rezulton se çmimi mesatar i këtij mjeti varion nga 2,500 deri në 3,500 euro, pra, shumë herë më pak se shifra 8,800 euro që i referohet Komisioni. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi dhe provoi se sipas pagesës së doganës për këtë mjet, nga personi që e ka sjellë në Shqipëri, për të cilën dogana ka marrë referencat e saj dhe (jo sipas faturës së paraqitur nga personi që e ka sjellë në Shqipëri) ka përcaktuar edhe taksën doganore. Sipas referencës së doganës çmimi referues për këtë mjet ka qenë 490,628 lekë + 98,126 dogana = 588,754 lekë ose 4,177 euro, ndërkohë që subjekti pas 5 vjetësh e ka blerë mjetin me çmimin 3,500 euro, pra, çmim normal dhe jo të lirë.

4.6 Komisioni, referuar provave të administruara gjatë hetimit, atyre të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, si dhe shpjegimeve të subjektit gjatë

¹⁵ Kontratë shitblerjeje automjeti nr. ***, datë 25.2.2014, për blerje mjeti tip “Mercedes Benz” S500, me nr. shasie ***, me vlerë 2,500 euro. Palë shitëse A.Gj. dhe palë blerëse Enkel Peza; certifikata e pronësisë datë 13.1.2015 e mjetit tip “Mercedes Benz” S500, me nr. shasie ***, me targa ***, në emër të z. Enkel Peza.

seancës dëgjimore, vlerëson se subjekti shpjegoi dhe provoi me dokumentacion ligjor justifikues se çmimi i këtij automjeti i është referuar çmimit të tregut.

4.7 **Si konkluzion**, në lidhje me këtë automjet, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë pasurinë në pronësi, ka burime të ligjshme për blerjen e këtij automjeti dhe nuk ka kryer deklarim të rremë.

5. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 1,400,000 lekë

Faktet nga hetimit administrativ

5.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në shumën 1,400,000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

5.2 **Subjekti, si burim krijimi, ka deklaruar** të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesioni avokat, paga e inspektorit pranë INUK-ut, si dhe paga e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

5.3 Komisioni, për të vërtetuar deklaratimet e subjektit, kreu një hetim të thelluar lidhur me:

a. Të ardhurat e përfituara nga ushtrimi i profesionit të avokatit për të cilat konstatoi se:

5.4 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura për periudhën 2009 – 2011, si i vetëpunësuar në profesionin avokat, me xhiro në total 6,306,450 lekë.

5.5 Komisioni kërkoi informacion për këtë deklaratim të subjektit të rivlerësimit në Drejtorinë Rajonale Tatimore Kavajë dhe Durrës, e cila konfirmoi se: (i) DRT-ja Durrës¹⁶ konfirmon se tatimpaguesi Enkel Peza me NIPT ***, ka deklaruar kontribute të sigurimeve shoqërore, por nuk ka deklaruar të ardhura pranë administratës tatimore për periudhën 2009 – 2010. Ndërkohë, për vitin 2011 DRT-ja Durrës¹⁷ informon se subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, rezulton mosdeklarues për librat e shitjes dhe të blerjes, FDP e TVSH, dhe ky subjekt rezulton i regjistruar në përgjegjësinë tatimore TVSH, në datën 22.2.2011, dhe ka kaluar në status pasiv në datën 23.8.2012, si mosdeklarues, si dhe nuk figurojnë të dorëzuara *online* në sistemin tatimor që nga data e regjistrimit në përgjegjësinë tatimore TVSH për vitin 2011; (ii) Bashkia Kavajë¹⁸, në përgjigjen e saj, informon se subjekti i rivlerësimit ka likuiduar detyrimet tatimore për vitet 2009, 2010 dhe 2011, sipas deklaratimeve të xhiros së qarkulluar për secilin vit përkatës, si më poshtë vijon:

Periudha	Niveli qarkullimit vjetor	Detyrimet	Likuiduar
Viti 2009	2,017,000 lekë	81,066 lekë	81,066 lekë
Viti 2010	2,210,000 lekë	71,220 lekë	71,220 lekë
Viti 2011	2,079,450 lekë	27,070 lekë	27,070 lekë
Totali		179,356 lekë	179,356 lekë

¹⁶ Me shkresën nr. *** prot., datë 2.7.2018.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 19.12.2018.

¹⁸ Me shkresën *** , datë 14.11.2018.

5.6 DRT-ja Durrës konfirmon se ish-in paguar vetëm sigurimet shoqërore, ndërsa DRT-ja Kavajë konfirmon se janë likuiduar detyrimet tatimore për vitet 2009, 2010 dhe 2011, bazuar në nivelin e qarkullimit vjetor të deklaruar. Gjatë hetimit Komisioni kërkoi nga subjekti i rivlerësimit informacion në lidhje me qarkullimin e realizuar, faktik të tij në lidhje me biznesin, pasi vetëm kështu mund të bëhet e mundur të llogaritet fitimi neto që ka pasur subjekti i rivlerësimit.

5.7 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar se ka pasur qarkullim faktik, paraqiti dokumentacion ligjor justifikues për periudhën 2009 – 2011¹⁹, si dhe shpjegoi se për këtë periudhë ka deklaruar si qarkullim total vlerën 6,306,450 lekë, të cilës i zbriten shpenzime avokatie, si vijon: (i) shpenzimet për pagesën e tatimeve dhe taksave pranë DTTV-së Kavajë; (ii) shpenzimet vjetore për pagesat e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore; (iii) shpenzimet vjetore për kontributin në Dhomën Kombëtare të Avokatisë; dhe (iv) shpenzime të tjera vjetore kancelarie apo të ndryshme, duke konkluduar se të ardhurat e tij në bazë të xhiros totale duke zbritur shpenzimet e avokatisë për periudhën 2009 – 2011, kanë qenë në vlerën 4,000,000 deri 4,500,000 lekë.

5.8 Për të vërtetuar deklaratimet e tij, subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar kopje të njoftim - vlerësimeve tatimore të bashkisë Kavajë, ku specifikohen zërat e detyrimeve përkatëse, si dhe kopje të dokumentacionit bankar për pagesën e këtyre detyrimeve, si më poshtë vijon:

Lloji i taksës sipas njoftim - vlerësimit	2009	2010	2011
Taksë regjistrimi	20,000	-	-
Taksë tabelle	700	120	120
Tarifë pastrimi	13,000	14,000	14,000
Tarifë ndriçimi	1,000	2,000	2,000
Tarifë gjelbërimi	1,000	1,000	1,000
Tarifë për ndërtesën	-	900	900
Tarifë për librezën	1,200	200	200
Detyrimi tatimor gjithsej mbështetur në qarkullimin vjetor	44,416	53,000	8,850
Total	81,316	71,220	27,070

Pagesat e sipërcituara konfirmohen edhe nga përgjigjja e përcjellë me shkresën nr. *** prot., datë 14.11.2018, nga bashkia Kavajë.

5.9 Subjekti, për të vërtetuar qarkullimin faktik të të ardhurave të tij si avokat, depozitoi gjatë hetimit libra shitje për vitet 2009, 2010 dhe 2011, me të dhëna për shitjet, respektivisht: (i) viti 2009, shitje në vlerën 1,960,000 lekë; (ii) viti 2010, shitje në vlerën 2,170,000 lekë; dhe (iii) viti 2011, shitje në vlerën 495,000 lekë.

¹⁹ a) Licencat e avokatisë për periudhën 2009 – 2014; b) vërtetim datë 20.10.2016; c) vërtetim nr. ***, datë 9.11.2018; d) vërtetim nr. ***, datë 9.11.2018, të DTTV-së Kavajë; e) vërtetim për pagesën e sigurimeve nga data 1.4.2009 – 31.12.2010 dhe nga data 1.1.2011 – 31.12.2011.

5.10 Bazuar në nenin 9, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, parashikohet: “*Në taksat vendore përfshihen: 1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël...*”.

5.11 Në pikën 3, të nenit 10, të ligjit nr. 9632, parashikohet: “*Çdo subjekt i cili kryen biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8.000.000 lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore për biznesin e vogël*”.

5.12 Në neni 11 të po këtij ligji, parashikohet: “*...për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, detyrimi fiskal tregues është i fiksuar për çdo kategori biznesi dhe nuk varet nga qarkullimi. Për bizneset me qarkullim më të madh se 2 milionë lekë deri në 8 milionë lekë në vit, detyrimi fiskal tregues është i barabartë me shumën e detyrimit për bizneset me qarkullim deri në 2 milionë lekë, shtuar me vlerën që del nga shumëzimi i madhësisë prej 1,5 për qind me vlerën në lekë të mesit të çdo intervali i qarkullimit 2-8 milionë lekë, përjashtuar rastet e ambulanteve dhe të transportit, të cilat kanë një mënyrë tjetër taksimi, që tregohet në të njëjtin aneks, që i bashkëlidhet këtij ligji...*”

5.13 Bazuar në nenin 12, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”, ndryshuar me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 (shfuqizuar me ligjin nr. 177, datë 28.12.2013), parashikohet: “*Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8 000 000 lekë dhe jo më pak se 2 000 000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale.*”

5.14 Pra, referuar dispozitave ligjore të përmendura më lart, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka biznes të vogël si person fizik dhe, për rrjedhojë, funksionon për efekt të takimeve në bazë të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, si dhe të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”. Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit vërtetoi se ka likuiduar detyrimet tatimore për vitet 2009, 2010 dhe 2011 pranë bashkisë Kavajë, si pushtet lokal i përcaktuar nga ligji për administrimin e taksave vendore, për një qarkullim vjetor deri në vlerën 2.000.000 lekë.

5.15 Duke qenë se neni 12/6, i ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”, parashikon: “*Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, sipas përcaktimit të dhënë në shkronjën "gj" të nenit 8 të këtij ligji, është i detyruar që, deri më 31 mars të vitit që pason periudhën tatimore, të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat, gjithsej, shpenzimet e zbritshme, e ardhura e tatueshme, tatimi për t'u paguar, taksa vendore, e paguar gjatë periudhës tatimore pranë organeve të qeverisjes vendore...*”, subjektit iu kërkua qarkullimi faktik në përputhje me këtë dispozitë.

5.16 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigjen e tij²⁰, dërgoi shkresë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të Bashkisë Kavajë²¹, e cila konfirmonte se: “*Niveli i qarkullimit vjetor faktik sipas librit të shitjeve, të mbajtur nga vetë subjekti, për periudhën 2009 – 2011, janë në tabelën e mëposhtme*”.

²⁰ E-mail datë 7.6.2019, protokolluar me nr. ***.

²¹ Shkresë nr. *** prot., datë 7.6.2019.

Periudha	Niveli i qarkullimit vjetor faktik
Viti 2009	1,960,000 lekë
Viti 2010	2,170,000 lekë
Viti 2011	495,000 lekë
TOTALI	4,625,000 lekë

5.17 Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore të bashkisë Kavajë konfirmoi për Komisionin të dhënat më lart.

b. Të ardhurat për periudhën 2012 – 2014, si i punësuar në studion e avokatisë “A.P.”

Faktet nga hetimi administrativ

5.18 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka të ardhura për periudhën 2012 – 2014, si i punësuar në studion e avokatisë “A.P.”, i siguruar me pagë minimale, që varion nga vlera 17,000 lekë deri në 22,000 lekë.

5.19 **Subjekti, në përgjigjen e tij** gjatë hetimit, ka deklaruar se për periudhën në vazhdim 2012 – 2014, sipas listpagesës së sigurimeve shoqërore që është dorëzuar nga babai i subjektit, z. A.P., pranë DRT-së Durrës, si dhe vërtetimit të pagesave të sigurimeve, ka qenë i punësuar në studion e avokatisë “A.P.”, me pagë 17,000 lekë deri 22,000 lekë. Subjekti, për të vërtetuar deklaratimet e tij, ka bashkëlidhur vërtetimin për pagesën e sigurimeve nga data 1.1.2014 – 31.8.2014, si dhe listpagesat e dorëzuara në DRT-në Durrës nga z. A.P., praktika e sigurimeve ***, DRT-ja Durrës, periudha 2012 – 2013.

5.20 ISSH-ja, me vërtetimin për pagesën e sigurimeve nga data 1.1.2014 – 31.8.2014, si dhe listpagesat e dorëzuara në DRT-në Durrës nga z. A.P., praktika e sigurimeve ***, DRT-ja Durrës, periudha 2012 – 2013, ka konfirmuar se të ardhurat për këtë periudhë kanë qenë në vlerën 139,000 lekë për vitin 2012 – 2013 dhe 253,000 lekë për vitin 2014.

5.21 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr. *** prot., datë 5.12.2018, në përgjigje të shkresës të Komisionit, ka informuar se z. Enkel Peza, me NIPT ***, ka kaluar me status pasiv që prej datës 23.8.2012 dhe rezulton mosdeklarues për librat e shitjes dhe të blerjes dhe FDP e TVSH-së për vitin 2011.

5.22 Në bazë të listpagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore, të ardhurat bruto mbi të cilën llogariten sigurimet shoqërore për vitin 2012 dhe vitin 2013, z. Enkel Peza, ka qenë i punësuar në studion e avokatisë së babait të tij, si më poshtë:

	Qershor - dhjetor 2012			Viti 2013		
	Paga bruto	Tatim mbi të ardhurat	Paga neto	Paga bruto	Tatim mbi të ardhurat	Paga neto
Enkel Peza	146,000	7,000	139,000	258,000	4,400	253,600
A.P.	127,310			225,000		

c. Të ardhurat e tjera të deklaruara

5.23 Në lidhje me: (i) të ardhurat nga paga si inspektor pranë INUK-ut, për periudhën shtator 2014 – janar 2015, në shumën 235,995 lekë; (ii) të ardhurat nga paga si ndihmësligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në periudhën qershor 2015 – dhjetor 2016, në shumën 1,188,583 lekë; (iii) kartën e kreditit në “BKT”, me limit 60,000 lekë – subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor provues se këto të ardhura ishin nga burime të ligjshme nga puna pranë këtyre institucioneve.

5.24 Subjektit të rivlerësimit, bazuar në faktet e sipërpërmendura, iu dërguan si rezultate hetimi konstatimet në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti si avokat, për sa vijon: (i) ka mospërputhje deklarimesh midis deklarimeve të subjektit dhe dokumentacionit të paraqitur në lidhje me shitjet e realizuara për vitet 2009, 2010 dhe 2011; (ii) në lidhje me qarkullimin faktik nga aktiviteti si avokat ka mospërputhje midis informacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës dhe informacionit të dërguar nga bashkia Kavajë; dhe (iii) subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar deklaratën vjetore tatimore të vitit 2010 dhe ka paguar vetëm detyrimin tatimor për taksën vendore, por jo vlerën e detyrimeve tatimore të tjera që mund të kishin rezultuar pas plotësimit të deklaratës vjetore sipas legjislacionit në fuqi.

5.25 Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet përfundimtare dhe gjatë seancës dëgjimore, shpjegoi se:

- i. Në lidhje me mospërputhjet për sa i përket shitjeve të realizuara në vitet 2009, 2010 dhe 2011, qarkullimi i deklaruar nga subjekti nuk është qarkullim faktik, por vetëm parashikim, ndërsa qarkullimi real është ai që del nga librat e shitjes. Ndërkohë, subjekti në pyetësonin nr. 3, qarkullimin total e ka konsideruar si të realizuar dhe, konkretisht, në pikën 4 (të pyetësorit) ka deklaruar se: “Qarkullimit total në vlerën 6,306,450 lekë i zbriten si shpenzime avokatie: shpenzimet për pagesën e tatimeve dhe taksave pranë DTTV-së Kavajë; shpenzimet vjetore për pagesat e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore; shpenzimet vjetore për kontributin në DHKA-në; shpenzime vjetore kancelarie; dhe shpenzime të ndryshme. Fitimi në total si njësi shërbimi avokatie në bazë të xhiros totale, duke zbritur shpenzimet e avokatisë për periudhën 2009 – 2011, kanë qenë në vlerën nga 4,000,000 – 4,500,000 lekë”.
- ii. Mosplotësimin e deklaratës vjetore tatimore të vitit 2010 subjekti e ka konsideruar si mangësi procedurale të DTTV-së Kavajë, e cila në përgjigje të saj ka konfirmuar faktin e mosnjohimit të subjekteve të tjera, përfshirë edhe subjektin Enkel Peza.

5.26 Komisioni, në analizë të dispozitave më lart, vlerëson se duke qenë se subjekti “Enkel Peza” deklaroi që në vitin 2010 qarkullimi faktik ka qenë në shumën 2,170,000 lekë, ka pasur detyrimin të plotësojë deklaratën vjetore tatimore për vitin 2010.

5.27 Për arsye se detyrimet tatimore nuk janë deklaruar dhe nuk janë paguar sipas legjislacionit, për rrjedhojë, për efekt të analizës financiare për vitin 2010 do të konsiderohet si fitim nga ushtrimi i aktivitetit si avokat vetëm fitimi në masën për të cilën janë paguar detyrimet tatimore ($53.000 \text{ lekë} / 10\% = 530.000 \text{ lekë}$).

5.28 Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni, duke marrë në konsideratë: (i) të ardhurat nga ushtrimi i profesionit si avokat për periudhën 2009 – 2011; (ii) të ardhurat si i punësuar në studion e avokatisë “A.P.”; (iii) të ardhurat nga paga si inspektor pranë INUK-ut;

dhe (iv) të ardhurat nga paga si ndihmësligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë, duke përfshirë edhe shpenzimet, konstatohet sa më poshtë vijon:

Analiza financiare

Viti	Të ardhurat nga aktiviteti si avokat	Të ardhura të tjera	Pasuri	Shpenzime ²²	Balanca e fondeve (progresive) ²³
2006		776,557	776,557	-	-
2007		-	-	-	-
2008		-	-	-	-
2009	1,313,200		-	40,000	1,273,200
2010	530,000		-	80,000	1,723,200
2011	331,650	45,000	-	197,830	1,902,020
2012		139,000	-	80,000	1,961,020
2013		253,600	110,000	95,000	2,009,620
2014		207,632	350,275	124,314	1,742,663
2015		458,213	-	152,590	2,048,286
2016		758,733	473,445	379,237	1,954,337
TOTAL	2.174.850	2,638,735	1,710,277	1,148,971	

5.29 Komisioni, referuar provave të administruara gjatë hetimit, atyre të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të barrës së provës, shpjegimeve të subjektit gjatë seancës dëgjimore, dhe analizës financiare të kryer nga Komisioni, vëren se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të krijuar likuiditet *cash* në shumën 1,954,337 lekë.

5.30 Në konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka burime financiare të ligjshme për të krijuar shumën 1,400,000 lekë, likuiditet *cash* i deklaruar në deklaratën “Vetting”, duke marrë në konsideratë të ardhurat e përfituara për vitet 2009, 2010 (vetëm fitimi në masën për të cilën janë paguar detyrimet tatimore) dhe 2011, sipas tatimeve të paguara dhe qarkullimit faktit të dërguar nga bashkia Kavajë.

5.31 Komisioni, në lidhje me mospërputhjet në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe të dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në lidhje me shitjet e realizuara për vitet 2009, 2010 dhe 2011, vlerëson se ka mospërputhje në lidhje me shumatat e deklaruara, mospërputhje të cilat kanë ardhur si rezultat i paqartësisë së termave, qarkullim vjetor, mbi të cilat janë paguar tatimet dhe qarkullim faktik mbi të cilin llogaritet fitimi.

6. Pasuri të tjera në përdorim të subjektit i rivlerësimit, pa kundërshpërblim

Faktet nga hetimit administrativ

6.1 Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar si adresë të plotë banimi të regjistruar në gjendjen civile: Lagjja nr. ***, pranë ish-Fabrikës së ***, banesë private nr. ***, Bashkia Kavajë, për të cilën ka bashkëlidhur dokumentacion justifikues.²⁴

²² Shpenzimet jetike për periudhën 2009 – tetor 2016, janë konsideruar zero, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka jetuar me prindërit përgjatë kësaj periudhe.

²³ Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur detyrim që të deklarojë gjendjet e parave/kursimeve *cash* në fund të çdo viti. Si rrjedhim, në kolonën “Balanca e fondeve (progresive)”, është përllogaritur mundësia financiare për kursim e subjektit të rivlerësimit.

²⁴ Vërtetim pronësie të lëshuar nga Hipoteka Kavajë për shtëpi banimi 2+1, ndodhur në Kavajë, në emër të babait të subjektit, z. A.P., që i korrespondon dhe adresës së deklaruar në Kavajë; certifikatë pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Tiranë me datë 4.10.2006, për apartamentin me

6.2 Përveç adresës së parë, subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 ka deklaruar edhe një adresë të dytë, ndodhur në Rr. “***”, p. nr. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, pranë ish-markatës, Bashkia Tiranë, duke bashkëlidhur certifikatën e pronësisë në emër të babit të tij.

6.3 Subjekti, në deklaratën “Vetting”, pavarësisht faktit që ka deklaruar dy adresa, një si adresë të plotë të regjistruar në gjendje civile dhe tjetrën si adresë vendqëndrimi, ka bashkëlidhur edhe dokumentacion justifikues për identifikimin e këtyre pasurive, për të cilat nuk ka deklaruar posedimin, përdorimin apo pronësinë e tyre.

6.4 Gjithsesi, nga dokumentacioni dhe përgjigjet e subjektit konstatohet se ai banon pa kundërshpërblim me prindërit në një banesë të ndërtuar prej tyre, në Kavajë në adresën: Lagjia nr. ***, pranë ish-Fabrikës së ***, banesë private nr. ***, Bashkia Kavajë, si dhe në adresën: Rr. “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ****, pranë ish-markatës, Bashkia Tiranë, në pronësi të z. A.P., babai i subjektit.

6.5 Për të verifikuar nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontribuar financiarisht në këto banesa dhe nëse ky kontribut ishte nga burime të ligjshme të tij dhe/ose të personit tjetër të lidhur, babait të tij, Komisioni ka hetuar si më poshtë:

Me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2018, ZVRPP-ja Kavajë ka vënë në dispozicion dokumentacionin e pasurisë truall me sip. 500 m² dhe ndërtesë me sip. 325 m², në lagjen nr. *** Kavajë, nga ku konstatohet se: Relacioni teknik i përpiluar nga grupi i punës, i caktuar me vendim të kryetarit të bashkisë, të cilët bëjnë verifikimin në terren, ku konfirmon se sipas hartës së zyrës së regjistrimit dhe sipas librit të ngastrave, ndërtesa është e vitit 1961, duke bashkëlidhur: (i) vërtetim pronësie i vitit 1993 ku vërtetohet se z. A.P. është pronar i një shtëpie banimi me dy dhoma, kuzhinë, sallon, verandë, depo dhe banjë; (ii) vendim nr. ***, datë 27.2.2016, i bashkisë Kavajë “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.8.1991 dhe të truallit funksional të saj”, me kërkues z. A.P., për kalimin në pronësi të paluajtshme, truall me sip. 577 m² dhe ndërtesë me sip. 325 m², në lagjen nr. *** Kavajë në emër të shtetasve A., H., Enkel, M. dhe M.P.; (iii) vendim i bashkisë Kavajë, datë 26.4.2017, për rishikimin e vendimit nr. ***, datë 27.12.2016, “Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më datë 10.8.1991 dhe truallit funksional të tyre”, ku vendosi: Kalimi në pronësi i pasurisë truall me sip. 500 m² + ndërtesë me sip. 325 m², në emër të shtetasve A., H., Enkel, M. dhe M.P.; (iv) vendim nr. ***, datë 28.4.2017, i Këshillit të Qarkut Tiranë, miraton vendimin nr. ***, datë 27.12.2016, të bashkisë Kavajë dhe konfirmon kalimin e pasurisë ndërtesë me sip. 325 m² dhe truall funksional me sip. 500 m² në emër të personave të mësipërm; (v) leje legalizimi, datë 31.10.2017, për shtesën e katit në objektin ekzistues 1 kat me të njëjtët bashkëpronarë; (vi) deklaratë noteriale, datë 30.10.2017²⁵, në të cilën z. A.P. deklaron se legalizimi i shtëpisë dykatëshe të bëhet në emër të gjashtë anëtarëve të familjes,

sip. 47.6 m², me adresë: Rr. “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ****, Tiranë, në emër të z. A.P., që i korrespondon adresës së deklaruar nga subjekti si vendqëndrim. Kjo shtëpi është blerë me kontratën nr. ***, datë 18.9.2006, blerë me çmimin 1,900,000 lekë jashtë zyrës noteriale.

²⁵ Deklarata noteriale me nr. ***, përpara noterit S.S., Kavajë.

A., H., Enkel, M., M. dhe E.P.; (vii) kartelë pasurie për truall me sip. 500 m² dhe ndërtesë me sip. 325 m² në emër të shtetasve A., H., Enkel, M., M.P.

6.6 Sipas subjektit të rivlerësimit, kjo pasuri është ndërtuar përpara vitit 2006 (rreth viteve 2000), shtuar një kat mbi objektin ekzistues. Për këtë ndërtim, nga z. A.P. është bërë vetëdeklarim me nr. ***, datë 5.9.2006, për legalizimin e shtesës në bashkinë Kavajë. Komisioni, në lidhje me shtëpinë në Kavajë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe ka kërkuar vendimin nr. ***, datë 3.9.1992, i cili vërteton faktin juridik të shtëpisë në Kavajë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë i ka dërguar Komisionit vendimin nr. ***, datë 3.9.1992, me paditës A.P., me objekt “vërtetim fakti juridik për shtëpi banimi”. Nga vendimi i gjykatës rezulton se shtëpia në Kavajë është ndërtuar në prill të vitit 1992, ndërkohë, nga deklarimi i subjektit dhe nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP-ja Kavajë, rezulton që pronësia për këtë shtëpi, së bashku me truallin funksional, është përfituar me VKM-në nr. ***, e cila ka si përcaktim shtëpi të ndërtuara deri në datën 10.8.1991.

6.7 Kjo shtëpi/pasuri, fillimisht ka qenë e regjistruar në ZVRPP-në Kavajë, vetëm në emër të babait të subjektit, z. A.P., deri në maj të vitit 2017.

6.8 Në bazë të VKM-së nr. 608, “Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”, babai i subjektit, z. A.P., ka filluar procedurat për regjistrimin e ri të pasurisë dhe në zbatim të vendimit nr. ***, datë 28.4.2017, të Këshillit të Qarkut Tiranë është bërë kalimi i truallit dhe i banesës në pronësi të familjes Peza.

6.9 Ky vendim është dërguar në ZVRPP-në Kavajë dhe është regjistruar në datën 15.5.2017 në emër të shtetasve A., H., Enkel, M., M. dhe E.P., që janë në përbërjen e certifikatës familjare, datë 10.8.1991.

6.10 Komisioni, në lidhje me shtëpinë në Kavajë, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë dhe i ka kërkuar vendimin nr. ***, datë 3.9.1992 i cili vërteton faktin juridik të shtëpisë në Kavajë.

6.11 Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kavajë i ka dërguar Komisionit vendimin nr. ***, datë 3.9.1992, me paditës A.P., me objekt “vërtetim fakti juridik për shtëpi banimi”. Nga vendimi i gjykatës rezulton që shtëpia në Kavajë është ndërtuar në prill të vitit 1992, ndërkohë, nga deklarimi i subjektit dhe nga dokumentacioni i përcjellë nga ZVRPP-ja Kavajë rezulton që pronësia për këtë shtëpi, së bashku me truallin funksional, është përfituar me VKM-në nr. ***, ku ka si përcaktim shtëpi të ndërtuara deri më 10.8.1991.

6.12 **Komisioni, me pyetësin nr. 7, i është drejtuar personit tjetër të lidhur, z. A.P. të japë shpjegime në lidhje me këtë mosrakordim, referuar periudhës së ndërtimit të shtëpisë.**

6.13 Z. A.P., në lidhje me këtë pyetje, ka sqaruar se shtëpia është ndërtuar në vitet 1960 – 1965. Objekti fillestar është shembur pjesërisht dhe më pas ka filluar të ndërtohet dhe të përshtatet në shtëpi banimi në vitin 1991, kur bashkëshortët kanë ardhur në Kavajë. Objekti ka përfunduar si karabina, i mbuluar, me suvatime të brendshme, instalime etj., por nuk ka qenë i tëri i banueshëm si shtëpi, pasi jo të gjitha dhomat ishin të shtruara, me dyer dhe dritare, dhe janë

futur për të banuar në fund të qershorit të vitit 1991, duke përdorur fillimisht një pjesë të objektit si banesë.

6.14 Në prill – maj të vitit 1992 babai i subjektit ka përfunduar punimet e mbetura të objektit, i cili është bërë i tëri i banueshëm. Në gusht të vitit 1992 ka bërë kërkesën për vërtetimin e faktit juridik, shtëpi banimi.

6.15 Gjykata, për vërtetimin e faktit juridik, është bazuar në kërkesën e babait të subjektit, e cila ka vlerësuar dhe ka konsideruar se momenti kur duhet të vërtetohej fakti juridik, shtëpi banimi, është momenti kur shtëpia bëhet e gjitha e banueshme (prill – maj 1992), pasi është bërë kërkesë për vërtetim fakti, shtëpi banimi, dhe jo thjesht vërtetim fakti, ndërtim objekti. Kjo është arsyeja pse vendimi i gjykatës shprehet se kjo shtëpi është ndërtuar në prill të 1992.

6.16 Vërtetimi i fakteve juridike për shtëpitë, banesat apo sendet e paluajtshme nuk ndaloheshin nga Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile (1981-1982) që ishin në fuqi në atë kohë dhe këto regjistroheshin në hipotekë. Kur është kryer procedura e kalimit të pronësisë së ndërtesës së truallit në bazë të VKM-së nr. ***, datë 5.9.2012, e cila përcakton kalimin në pronësi për pasuritë e ndërtuara deri më 10.8.1991 dhe truallit funksional të tyre ku nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë, është bërë këqyrja në vend e objektit nga punonjësit e bashkisë Kavajë, të cilët kanë konkluduar se objekti ka qenë i përfunduar para datës 10.8.1991. Z. A.P. deklaron se nuk disponon dokumentacion tjetër përkatës që justifikon vitin e ndërtimit por kjo provohet me prova indirekte siç janë punësimi në fillim të vitit 1991 dhe librezat e punës së bashkëshortes që provojnë faktin e zhvendosjes me punë në fillimet e viteve 1991. Regjistrimi për herë të parë në shkollë të djalit Enkel Peza në shtator të vitit 1991 provon indirekt faktin që banojnë në këtë shtëpi që prej vitit 1991 në Kavajë.

6.17 Referuar deklaratës noteriale të bërë nga palët për procesin e legalizimit të ndërtesës Enkel Peza është pronar i truallit ku është bërë ndërtimi dhe më 27.12.2016 ka qenë përfitues i truallit si pjesë e certifikatës familjare të vitit 1991. Në këto kushte subjekti ka pasur detyrimin ligjor për të deklaruar pronësinë mbi këtë truall.

6.18 Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit në lidhje me konstatimet: (i) subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën “Vetting” të viti 2017 pronësinë mbi truallin dhe ndërtesën, duke përfshirë edhe ambiente të ndryshme si zyrë, banim etj.; (ii) subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje të deklaratimeve në lidhje me legalizimin e ndërtesës mbi të cilën është ndërtuar, pasi në deklaratën noteriale të dorëzuar nga subjekti kërkohet legalizimi i ndërtesës 2-katëshe, ndërkohë që vetëm kati i dytë ishte objekt legalizimi.

6.19 Subjekti i rivlerësimit në përgjigje të konstatimeve të dala nga hetimi administrativ kryesisht shpjegoi se të dy vendimet e bashkisë Kavajë të datës 27.12.2016 dhe 26.04.2017, janë një procedurë paraprake që kryhet nga ky organ, por që nuk kalojnë truallin në pronësi të aplikuesit sipas përcaktimeve të VKM-së nr. ***, datë 5.9.2012. Subjekti shpjegon se është vendimi nr. ***, datë 28.4.2017, i Këshillit të Qarkut Tiranë që miraton dhe konfirmon ligjshmërinë e vendimit nr. ***, datë 27.12.2016, të bashkisë Kavajë të rishikuar më 26.4.2017, vendim i cili bën kalimin e pasurisë së ndërtesës me sip. 325 m² dhe truallit funksional me sip. 500 m² në bashkëpronësi, duke përfshirë edhe emrin e subjektit. Ky vendim sipas subjektit është marrë 3 muaj pasi ka dorëzuar deklaratën “Vetting” dhe nuk kishte si ta deklaronte bashkëpronësinë e saj, pasi as nuk mund ta dinte që do t’i kalonte në pronësi.

6.20 Në lidhje me mospërputhjet për legalizimin e kateve të ndërtesës së banesës në Kavajë, subjekti shpjegon se nuk ka mospërputhje por ka një lapsus në tekstin e deklaratës së hartuar nga noteri. Për të vërtetuar të kundërtën, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur disa prova shkresore: vetëdeklarim për legalizimin e shtesës nr. ***, datë 5.9.2006, dhe lejen e legalizimit nr. ***, datë 31.10.2017; deklaratën noteriale nr. ***, datë 30.10.2017; kartelën e pasurisë së paluajtshme, datë 15.7.2017; shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2018, të ZVRPP-së Kavajë.

6.21 Komisioni, referuar hetimit administrativ kryesisht, shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit dhe analizimit të provave shkresore të dërguara nga subjekti i rivlerësimit, arrin në përfundimin se subjekti nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi këtë pasuri në deklaratën “Vetting” edhe pse e ka deklaruar si adresë banimi.

6.22 Sipas ligjit nr. 9049 datë 10.04.2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit të ILDKPKI-së nr. ***, datë 10.10.2016, “Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj, nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrimin për deklarim të pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016”, duke qenë se subjekti i rivlerësimit banon herë pas here në këtë ndërtesë, duke e deklaruar dhe si adresë banimi në pronësi të babit të tij, z. A.P., subjekti mbart detyrimin të paraqesë dokumentacion justifikues ligjor, në momentin e dorëzimit të deklaratës së pasurisë për pronësinë dhe burimin e krijimit të pronës, e cila bëhet objekt i kësaj marrëdhëniejeje me subjektin.

6.23 Në lidhje me këtë mosdeklarim të subjektit të rivlerësimit, Komisioni çmon se subjekti duhet ta kishte deklaruar përdorimin e kësaj pasurie në deklaratën “Vetting” të vitit 2017 dhe kjo përbën një pasaktësi në deklarim. Por, fakti që subjekti e ka deklaruar këtë banesë si adresë të tij alternative tregon se nuk ka pasur për qëllim fshehjen e saj.

6.24 Më tej, në lidhje me këtë mosdeklarim subjekti i rivlerësimit gjatë seancës dëgjimore deklaroi se i ka përdorur të dyja banesat, që fillimisht kanë qenë në pronësi të babait tij, një banesë në Kavajë dhe një tjetër në Tiranë. Subjekti deklaroi se ai nuk e ka deklaruar pasi ka pasur vështirësi në përcaktimin me saktësi të kohës që kishte jetuar në secilën prej banesave, pasi kishte kaluar kohë.

6.25 Në lidhje me mospërputhjet e kateve të legalizimit të kësaj pasurie subjekti i rivlerësimit provoi me dokumentacion ligjor se ishte një lapsus në deklaratën noteriale të hartuar nga noteri publik.

6.26 **Në konkluzion të sa më sipër**, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vlerëson se bazuar në provat që disponon, në vlerësimin e çështjes në tërësi dhe në bindjen e brendshme, në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, deklarimi i pasurive të subjektit të rivlerësimit, është në përputhje me detyrimet ligjore që subjekti i rivlerësimit ka pasur për të bërë në zbatim të legjisllacionit. Rrethana e analizuar më sipër nuk përbën arsye për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

7. Në lidhje me pasuritë e paluajtshme të përdorura nga subjekti i rivlerësimit, por që janë në pronësi të babait të subjektit të rivlerësimit

Faktet nga hetimit administrativ kryesisht

7.1 Në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pronësi apo përdorim mbi ndonjë pasuri në të cilën ai jeton me ose pa kundërshpërblim.

7.2 Ndërkohe që në deklaratën e pasurisë “Vetting”, në faqen nr. ***, subjekti ka deklaruar si adresë të plotë të regjistruar në gjendjen civile adresën: Lagjja nr. ***, pranë ish-Fabrikës së ***, banesë private nr. ***, Bashkia Kavajë (*të analizuar më lart*).

7.3 Po në deklaratën “Vetting” në faqen nr. ***, si vendqëndrim subjekti ka deklaruar adresën: Lagjja “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. ***, pranë ish-markatës, Tiranë.

7.4 Me qëllim që Komisioni të hetonte se ku banon subjekti dhe nëse ka kontribut financiar në to, është pyetur subjekti, i cili në përgjigje të pyetësorëve ka deklaruar se ka përdorur pa kundërshpërblim pasuritë familjare të mëposhtme:

- i. apartament në emër të babait A.P., në adresën: Lagjja “****”, p. ***, shk. ***, k. ***, ap. *** pranë ish-markatës, Tiranë;
- ii. zyrë e përdorur disa herë gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, pa pagesë qiraje me adresë: Blv. “****”, k. ***, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, zyrë e blerë nga babai A.P., me një kontratë sipërmarrje, datë 14.10.2010, por nuk është regjistruar në ZVRPP-në Toranë për shkak të parregullsive të ndërtuesit që lidhen me lejen e ndërtimit;
- iii. zyrë e përdorur disa herë gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit pa pagesë qiraje ku ushtron profesionin babai im, z. A.P., me adresë: Lagjja ***, pranë Gjykatës së Rrethit Kavajë.

7.5 Komisioni hetoi në lidhje me këto pasuri në emër të personit tjetër të lidhur, z. A.P., duke qenë se subjekti i rivlerësimit i ka përdorur këto pasuri për banim ose ushtrimin e aktivitetit të tij si avokat. Subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit ka deklaruar se: *“Në lidhje me apartamentin e ndodhur në Tiranë - nga muaji qershor 2018 për shkak të lidhjes së martesës pranë Njesisë Administrative Nr. ***, Tiranë, jam banor i kësaj Njësia Administrative. Në muajin qershor 2018, kam filluar bashkëjetesën me bashkëshorten në qytetin e Shkodrës në adresën: Lagjja ‘***’, Rr. ‘***’, ap. ***, Bashkia Shkodër. Kjo banesë është marrë nga bashkëshortja ime në janar 2017, përpara bashkëjetesës (për këtë fakt subjekti ka depozituar kontratën e qirasë²⁶). Nga analizimi i të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie nga personi tjetër i lidhur, z. A.P., rezultoi se ai ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie nga aktiviteti i tij si avokat dhe shitja e disa pasurive të paluajtshme.”*

7.6 Për përdorimin e zyrës së avokatisë në qytetin e Kavajës – Subjekti, në lidhje me shpenzimet e kryera për përdorimin e zyrës së avokatisë në kohën kur kryente aktivitet privat, ka deklaruar se nuk ka paguar qira për këtë zyrë, por qiraja është paguar nga babai i tij për të gjithë periudhën e punësimit si avokat dhe për ushtrimin e aktivitetit të tij.

7.7 Sipas dokumentacionit të administruar nga ZVRPP-ja Tiranë, ky apartament është blerë nga personi tjetër i lidhur, babait të subjektit më 18.9.2006, referuar kontratës së shitjes nr. ***, datë 18.09.2006.

²⁶ Kontratë qiraje datë 15.1.2018, lidhur mes qiradhënës D.T. dhe qiramarrës B.H.

7.8 Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka banuar në këtë apartament kohë pas kohe për nevojat e tij.

7.9 Nga hetimi administrativ u konstatua gjithashtu se ky apartament është blerë shumë më përpara se subjekti i rivlerësimit të fillonte punë si ndihmësligjor.

7.10 Për përdorimin e zyrës me adresë: Blv. “***”, Tiranë, deklaruar se është përdorur nga subjekti gjatë kohës kur ushtronte profesionin e avokatit - subjekti i është përgjigjur se koha në të cilën ka punuar herë pas here ka qenë nga viti 2009 deri gusht 2014. Edhe pse kontrata e sipërmarrjes është nënshkruar në vitin 2010, kjo pronë është poseduar nga babai z. A.P., që nga fundi i 2008 kur kanë filluar pagesat e para me bankë dhe më pas mandatpagesë (bashkangjitur mandatpagesat). Kjo zyrë nuk ka qenë qendra e ushtrimit të profesionit të avokatit, por përdorej subjekti dhe babai i tij kur kishin takime me klientë për çështje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Kjo pasuri nuk është regjistruar ende në ZVRPP-në Tiranë, për shkak të parregullsive në dokumentacionin ligjor të ndërtuesit.

7.11 Në lidhje me burimin dhe aftësitë paguese subjekti ka deklaruar se janë përdorur si burim të ardhurat e përfituara nga puna e babait si avokat që nga viti 1993 dhe në vazhdim.

7.12 Për këtë deklaram subjektit ka depozituar kontratën e sipërmarrjes nr. ***, datë 14.10.2010, lidhur ndërmjet shoqërisë “***” sh.p.k., dhe z. A.P. për ndërtimin e një dyqani me sip. 25 m² me çmimin 20,000 euro. Z. A.P. për këtë kontratë ka bërë pagesat, si vijon: pagesë në vlerën 544,400 lekë, datë 9.12.2008, në “Raiffeisen Bank” për shoqërinë “***” sh.p.k.; mandatarkëtimi në shumën 1,079,500 lekë, datë 9.12.2008, për shoqërinë “***” sh.p.k.; mandatarkëtimi në shumën 1500 euro + 150,000 lekë, datë 27.12.2008, për shoqërinë “***” sh.p.k.; mandatarkëtimi në shumën 5,060 euro, datë 15.3.2009, për shoqërinë “***” sh.p.k.

7.13 Referuar deklarameve të subjektit të rivlerësimit, provave të administruara gjatë hetimit, duke marrë në konsideratë vetëm të ardhurat e personit tjetër lidhur rezulton se personi tjetër i lidhur ka pasur të ardhura të ligjshme për të blerë këto pasuri të cilat kanë qenë në zotërim të subjektit të rivlerësimit për shkak të familjes dhe nga hetimi u vërtetua se të gjitha këto pasuri ishin krijuar para se subjekti i rivlerësimit të ishte emëruara ndihmësligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës Parë Tiranë.

8. Konkluzioni për kriterin e vlerësimit të pasurisë

8.1 Subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, deklaram i parë dhe i vetëm i subjektit, për shkak se: (i) nuk ka deklaruar përdorimin e pasurive (banesë në Kavajë, apartament në Tiranë, zyrë avokatie në Kavajë dhe Tiranë) pa kundërshtëpërbllim në pronësi të personit tjetër të lidhur, babait të tij; (ii) nuk ka deklaruar saktë të ardhurat neto të realizuara nga aktiviteti i tij si avokat, por vetëm qarkullimin vjetor; (iii) nuk ka deklaruar të drejtat reale mbi bashkëpronësinë në truallin dhe në ndërtesën 5-katëshe në Kavajë, që deri në momentin e deklaramit në deklaratën “Vetting” ishin në pronësi të personit tjetër të lidhur, babait të subjektit.

8.2 Gjithsesi, në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, barazisë së palëve, faktit që subjekti ka qenë në pozicionin e ndihmësligjor dhe nuk ka deklarime të mëparshme të interesave privatë, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, çmon

se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe se deklaratimet e pasakta të evidentuara më lart nuk përbëjnë shkak për pamjaftueshmëri në deklarinimin e pasurisë sipas pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

VI. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

1. **Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK)** ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit nr. 84/2016.

2. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

3. Si konkluzion, Grupi i Punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza.

4. Pavarësisht raportit të dërguar nga DSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

5. Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë informacion apo indice që të implikojë subjektin në kryerjen e ndonjë vepre penale apo në cenim të figurës, nuk ka denoncime apo të dhëna të tjera që të rezultojë se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

6. Në përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit e ka dorëzuar formularin e deklaratimit për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; ka konstatuar se subjekti nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, si dhe nuk ka bërë deklarinim të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH, të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

VII. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR AFTËSITË PROFESIONALE

Sipas pikës 2, të nenit 42, të ligjit nr. 84/2016, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, të cilët nuk janë magjistratë, vlerësohen bazuar në: a) relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe b) rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.

A. Në lidhje me relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura

Inspektorati pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, deri në krijimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në ligjin nr.

96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ka dorëzuar raportin profesional për subjektin e rivlerësimit, në të cilin nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, lidhur me kriteret e vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, janë vënë re këto gjetje:

ANALIZA E GJETJEVE

1. Aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, duke filluar nga qershori i vitit 2015. Rrjedhimisht, njohuritë e tij ligjore analizohen për periudhën qershor 2015 – 8 tetor 2016, për më pak se 3 vjet punë. Subjekti ka përzgjedhur tri dokumente ligjore (1 projektvendim dhe 2 opinione ligjore), nga të cilët dy prej tyre lidhen me çështje administrative të shqyrtuara në gjykatë gjatë periudhës së rivlerësimit. Këto tri dokumente ligjore tregojnë se subjekti ka trajtuar mosmarrëveshje që lidhen me shkarkimin nga detyra të funksionarëve të lartë nga Kuvendi i Shqipërisë . Subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, në hartimin e këtyre akteve ka identifikuar normën ligjore, *por nuk është thelluar për të evidentuar çështjet e rëndësishme për shqyrtimin e çështjes, siç është rasti i diferencës midis juridiksionit gjyqësor të zakonshëm dhe juridiksionit kushtetues*. Subjekti tregon se ka njohuri të përgjithshme edhe për jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, si dhe GJEDNJ-së. Për sa i përket pesë dosjeve të vëzhguara, rezulton se në to nuk është përfshirë asnjë akt i përgatitur nga subjekti i rivlerësimit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 5.6.2018, paraqet informacionin se me urdhrin nr. ***, datë 10.6.2015, të kryetarit të gjykatës, ndihmësi ligjor Enkel Peza është caktuar pranë gjyqtarëve S.Gj. dhe B.K. Nga kancelari i gjykatës është dërguar kopje e komunikimit elektronik që subjekti ka pasur me dy gjyqtarët B.K. dhe S.Gj. për hartimin e projektvendimeve. Këto akte elektronike nuk shoqërohen me kërkimet e gjyqtarit, apo me konfirmimin e gjyqtarit për saktësinë e tyre. Nga ana formale, ato nuk janë përgatitur si projektvendime *dhe nuk janë dokumentuar rregullisht sepse janë përgatitur nga ndihmësi ligjor*.

Në pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se ndihmësi ligjor është angazhuar në çështje gjyqësore që lidhen me legjislacionin e prokurorit publik, me procedurat e lëshimit të urdhrave të ekzekutimit për titujt ekzekutivë të përcaktuar me ligjin specifik, si dhe me vlefshmërinë e titujve ekzekutivë , me vlefshmërinë e akteve në procedurën e lidhjes së pensionit nga organet e sigurimeve shoqërore dhe me legjislacionin tatimor. Duhet evidentuar se në dy raste, ndihmësi ligjor është angazhuar vetëm në përcaktimin e fakteve dhe nuk ka dhënë kontribut në analizën ligjore të mosmarrëveshjes.

b) Arsytimi ligjor

Në të tria dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, aktet janë të shkruara qartë. Dy prej tyre paraqiten me strukturë të organizuar me pjesë, por mendimi i ndihmësit ligjor nuk jepet më vete, në formën e një propozim-vendimi sipas natyrës së çështjeve në tërësi. Në një dokument, argumentet e ndihmësit ligjor jepen të radhitura me

paragrafë, duke shprehur mendimin në lidhje me natyrën e çështjes, pa iu referuar ndonjë çështjeje konkrete, ndërsa në një dokument tjetër mendimi i ndihmësit është shprehur në projektvendim, në formën e vendimit për çështjen konkrete dhe mendimi nuk jepet më vete në formën e një propozim-vendimi. Në njëërën prej tri dokumenteve ligjore, të përzgjedhura nga vetë ndihmësi, është pasqyruar interpretimi dhe zbatimi i dispozitave ligjore në përgjithësi. Në një rast është konstatuar se në funksion të opinionit të tij ligjor për zgjidhjen e çështjes, subjekti i rivlerësimit ka cituar edhe raste nga jurisprudenca e GJEDNJ-së dhe ajo e Gjykatës Kushtetuese, apo dispozita kushtetuese, duke përdorur parimin e një procesi të rregullt ligjor, si dhe parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, ndërsa në një rast tjetër i është referuar praktikës së mëparshme gjyqësore. Në tri dokumentet ligjore të paraqitura nga ndihmësi ligjor *nuk mund të identifikohet nëse mendimi i ndihmësit ligjor përputhet me vendimmarrjen e gjykatës, pasi ato nuk janë shoqëruar me vendimet gjyqësore respektive.*

2. Aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, në funksionin e ndihmësit ligjor ka deklaruar se në periudhën qershor 2015 – 31.12.2016, ka marrë në dorëzim nga gjyqtari 953 dosje, nga të cilat 867 dosje për të hartuar projektvendim në çështje themeli, 70 dosje projektvendim nxjerrje urdhër ekzekutimi, 16 dosje projektvendim nxjerrje urdhër ekzekutimi dhe 16 dosje projektvendim sigurim padie. Ndihmësi Enkel Peza deklaron se në të njëjtën periudhë qershor 2015 – 31.12.2016, ka përfunduar gjithsej 953 çështje dhe nuk ka mbartur asnjë çështje në vitin 2017. *Këto të dhëna nuk dokumentohen me vërtetim të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.* Sipas informacionit zyrtar të paraqitur me shkresën nr. *** prot., datë 10.7.2018, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë për efekte të organizimit të përzgjedhjes së pesë çështjeve me short, rezultojnë të relatuara 855 çështje, nga të cilat 776 çështje administrative themeli dhe 79 kërkesa të veçanta.

Për sa i takon aspektit kohor, duke iu referuar të dhënave të përshkruara në tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, konstatohet se kohëzgjatja e proceseve të tij të punës ka qenë 3 muaj e 27 ditë, 1 muaj e 17 ditë, ndërsa në rastin e dokumentit 3 nuk mund përcaktohet kohëzgjatja, pasi nuk i referohet ndonjë çështjeje konkrete. Referuar të dhënave të pesë dosjeve gjyqësore, tek të cilat nuk janë përfshirë aktet e relatimit, kohëzgjatja nga dita e shortit deri në shpalljen e vendimit është 2 muaj e 5 ditë, 7 ditë, 2 muaj e 19 ditë, 1 muaj e 8 ditë dhe 2 muaj e 22 ditë – që të gjitha rastet janë jashtë afatit 30 ditor të përcaktuara në germën “c”, të pikës 5, të Aneksit të Sistemit të Vlerësimit dhe për një rast jashtë afatit 5 ditor, të nenit 511, të Kodit të Procedurës Civile. Megjithatë, duhet evidentuar se ky afat lidhet me veprimtarinë e gjyqtarit dhe për shkak të mungesës së dokumentimit të saktë të veprimeve të ndihmësit, nuk mund të identifikohet nëse shkaku kryesor i vonësës është mospëmbushja e detyrave nga ndihmësi ligjor, sipas nenit 6, të ligjit nr. 49/2012.

Referuar të dhënave nga pesë dokumentet e përzgjedhura me short, tek të cilat nuk janë përfshirë aktet e relatimit dhe as projektvendime të konceptuara zyrtarisht nga ndihmësi ligjor, rezulton se nga data e shpalljes së vendimit, deri në datën e dorëzimit me *e-mail* të dokumentit kanë kaluar 5 ditë, 3 ditë, 1 ditë para vendimmarrjes, brenda ditës dhe 2 ditë. Të dhënat e regjistrave të gjykatës tregojnë se në asnjë rast prej pesë dosjeve të vëzhguara, nga gjyqtari nuk

është tejkualuar afati ligjor 7 ditor, i përcaktuar nga neni 42/3, i ligjit nr. 49/2012, për dorëzimin e vendimit të arsyetuar prej tij. Për pasojë, konkludohet se ndihmësi ligjor ka vepruar duke ndihmuar gjyqtarin në respektimin e afateve për arsyetimin e vendimeve dhe depozitimin e dosjeve gjyqësore në sekretari.

Si përmbledhje, në analizën e këtyre të dhënave për aftësinë për të përballuar ngarkesën në punë të ndihmësit ligjor Enkel Peza, duhen evidentuar dy faktorë: (i) kuadri ligjor në fuqi nuk përcakton standarde minimale pune për ndihmësin ligjor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë; (ii) mungesa e të dhënave mbi kohën e caktimit të çështjeve për përgatitje, referuar vetëm datës së *e-mail*-it të ndihmësit, datës së dhënies së vendimit nga gjykata dhe afatit të dorëzimit të dosjes bashkë me vendimin e arsyetuar nga gjyqtari, nuk mundëson evidentimin e saktë të punës së ndihmësit ligjor për llogaritjen e kohëzgjatjes së secilit relacion, por lejon vetëm vlerësim në tërësi të punës së tij me punën e gjyqtarit përkatës.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga të gjitha praktikat e administruara të përzgjedhura me short nuk ka dokumentim të veprimeve të kryera nga ndihmësi ligjor, me qëllim matjen saktësisht të kësaj aftësie. Nga përmbajtja e tri dokumenteve ligjore konstatohet se në një rast ndihmësi ligjor ka studiuar çështjen gjyqësore dhe ka bërë kërkime ligjore, duke përgatitur opinionin me shkrim për problematikat ligjore për çështje të së njëjtës natyrë në përgjithësi, por jo për çështjen në gjykim në veçanti, ndërsa në një rast opinionin ligjor nuk tregon se i referohet ndonjë çështje konkrete në gjykim. Këto veprime subjekti i ka materializuar në opinion dhe në projektvendim, të cilat përmbajnë elementët proceduralë të kërkuar në nenin 6, të ligjit nr. 49/2012. Detyrat e ndihmësit ligjor të gjykatave administrative janë parashikuar në nenin 6 të ligjit nr. 49/2012 dhe konkretisht në paragrafin 1 e 2 të këtij ligji parashikon: “1. Gjyqtari i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit Administrativ, në veprimtarinë e tij ndihmohet nga ndihmësi ligjor. 2. Ndihmësi ligjor ndihmon dhe këshillon gjyqtarin lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor, si dhe përgatit projekt-akte procedurale të nevojshme për gjykimin”. Me kërkesë të gjyqtarit ndihmësi ligjor bën kërkime ligjore dhe përgatit opinionin me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim. Në pesë dosjet e vëzhguara nuk mund të nxirret asnjë e dhënë lidhur me aftësinë për të kryer procedurën gjyqësore të ndihmësit ligjor, pasi nuk ka asnjë akt të përgatitur sipas parashikimeve ligjore. Komunikimi elektronik i përcjellë nga kancelari i gjykatës tregon angazhimin e ndihmësit ligjor vetëm në fazën e fundit të gjykimit për hartimin e vendimit gjyqësor prej gjyqtarit.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Në pesë dosjet e përzgjedhura me short nuk është përfshirë ndonjë akt që të dokumentojë ndihmën dhe këshillimin, që ndihmësi ligjor Enkel Peza i ka dhënë gjyqtarëve S.Gj. dhe B.K. lidhur me përgatitjen e çështjes për gjykim dhe shqyrtimin gjyqësor për përgatitjen e ndonjë projektakti procedural të nevojshëm për gjykimin, që të mbajë nënshkrimin në cilësinë e konceptuesit prej ndihmësit ligjor Enkel Peza, si dhe ndonjë kërkesë nga gjyqtarët S.Gj. dhe B.K. drejtuar ndihmësit ligjor, për të bërë kërkime ligjore apo për të hartuar opinionin me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjen në fjalë.

Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga subjekti konstatohet se dy prej tyre nuk kanë datë përpilimi dhe nuk janë nënshkruar në çdo faqe, por në faqen e fundit nga ndihmësi ligjor, ndërsa një dokument ligjor ka datë përpilimi dhe është nënshkruar në faqen e parë dhe të fundit nga ndihmësi ligjor. Në asnjë rast konceptimi i ndihmësit ligjor nuk është nënshkruar nga gjyqtari, si dhe nuk shoqërohet me vulë nga gjykata për të treguar njësimin e tij me origjinalin.

Nga vëzhgimi i pesë dosjeve të përzgjedhura me short u konstatua se ndihmësi ligjor Enkel Peza ka vepruar përmes komunikimit elektronik, i cili gjithashtu nuk përmbush standardet e komunikimit zyrtar për disa arsye: (i) komunikimi elektronik është kryer në adresa private *e-mail*-i; (ii) në komunikimin elektronik janë dërguar vetëm dokumente bashkëlidhur dhe nuk është shënuar asnjë tekst për të identifikuar se cilat detyra janë kërkuar nga gjyqtari dhe cilat janë plotësuar nga ndihmësi, në raport edhe me afatet e kërkuara nga gjyqtari; (iii) në komunikimin elektronik nuk gjendet konfirmimi i gjyqtarit mbi shpejtësinë dhe cilësinë e punës prej ndihmësit ligjor. Dokumentet e shkëmbyera në rrugë elektronike nga ndihmësi nuk janë konceptuar nga ana formale si projektakte të përgatitura prej tij dhe në asnjë rast nuk janë nënshkruar prej tij. Këto akte nuk rezultojnë të konfirmuara formalisht prej gjyqtarit përkatës.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, konstatohet se nga qershori 2015 dhe aktualisht, ushtron detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në Këshillin e Lartë të Drejtësisë nuk ka të dhëna nga burimet arkivore për këtë aspekt.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nga tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza. Në tri dokumentet ligjore nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjerë që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Ndërsa, asnjë prej tri dokumenteve ligjore dhe pesë dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo çështje që lidhet me pakicat. Po ashtu, në këto tri dokumente ligjore nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave. Për sa i përket pesë dosjeve të vëzhguara, duhet ritheksuar se në to nuk ka asnjë akt procedural formal që i përket subjektit të rivlerësimit.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Në tri dokumentet ligjore nuk ka të dhëna për mënyrën e komunikimit të subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza, me palët ndërgjyqëse, pasi për shkak të natyrës së punës nuk ka kontakt me ta. Në të tria dokumentet ligjore, gjuha e përdorur në akte është normale.

Për sa i përket pesë dosjeve të vëzhguara, duhet ritheksuar se në to nuk ka asnjë akt procedural që i përket subjektit të rivlerësimit. Për më tepër, në komunikimin elektronik me gjyqtarin bie në sy fakti se ndihmësi i drejtohet gjyqtarit respektiv me *e-mail*, pa asnjë tekst brenda, gjë që tregon se mënyra e komunikimit nuk demonstroi rregullat e komunikimit zyrtar që duhen ndjekur në marrëdhënien ndihmësligjor – gjyqtar.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Ndërkohë, në asnjë prej tri opinioneve/relacioneve të vëzhguara nuk evidentohet problematikë në bashkëveprimin e tij me gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, pranë të cilëve ka ushtruar detyrën e ndihmësit ligjor. Njëra prej relacioneve të vëzhguara, e konceptuar nga ndihmësi ligjor në emër të gjyqtarës, nuk është nënshkruar nga kjo e fundit. Mënyra e komunikimit të ndihmësit ligjor me gjyqtarin është bërë në mënyrë të njëanshme, me *e-mail*, pa tekst. Në rastin e opinioneve ligjore nuk ka të dokumentuar ndonjë kërkesë të gjyqtarit për të përgatitur opinion me shkrim për problematika ligjore të karakterit procedural dhe material që lidhen me çështjet në gjykim. Aktet e pretenduara si të përgatitura prej tij, që shoqërojnë *e-mail*-et (sipas procesverbalit nr. *** prot., datë 11.9.2018, të mbajtur nga kancelari i gjykatës dhe ndihmësi ligjor), nuk janë konceptuar nga ana formale si projektakte në vështrim të nenit 6/2, të ligjit nr. 49/2012. Por, mungesa e rregullave të posaçme për evidentimin e punës së ndihmësit ligjor, siç parashtron edhe kryetari i gjykatës me shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2018, duket se ka ndikuar në evidentimin e punës së ndihmësit ligjor.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, ka marrë titullin “jurist” në Universitetin Jopublik “***”, Tiranë në vitin 2007. Subjekti ka dhënë provimin e gjuhës angleze dhe të gjuhës italiane në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, në Universitetin e Tiranës. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjithashtu se për periudhën e vlerësimit qershor 2015 – tetor 2016 ka marrë pjesë në 3 seminare, gjithsej 4 ditë trajnim në Shkollën e Magjistraturës. Temat e këtyre trajnimeve lidhen me detyrën e ndihmësit ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

B. Në lidhje me rezultatet e testimit në Shkollën e Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës, me shkresën nr. ***, datë 23.5.2018, ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*.

Me vendimin nr. ***, datë 21.5.2018, këshilli drejtues i Shkollës së Magjistraturës ka vendosur të miratojë rezultatet e testimit profesional të subjekteve *ex officio*, të shpallura nga Komisioni i Mbikëqyrjes së Vlerësimit Elektronik (faza e parë) dhe Komisioni i Vlerësimit të Testit Profesional (faza e dytë), sipas listave bashkëlidhur këtij vendimi, si pjesë përbërëse të saj, nga ku rezulton se subjekti i rivlerësimit ka marrë mbi 60 % të pikëve të testit të aftësive profesionale.

C. Vlerësimi i Komisionit

1. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të referuar më lart, Komisioni, ka konstatuar se:

- i. Nuk evidentohet mënyra se si është kryer procedura e kërkimit të opinionit nga gjyqtari i çështjes ndaj ndihmësit ligjor dhe mënyra e dërgimit të këtij opinionit nga ky i fundit te gjyqtari përkatës.
- ii. Nuk evidentohet mënyra se si është kryer procedura e kërkimit të projektvendimit nga gjyqtari i çështjes ndaj ndihmësit ligjor dhe mënyra e dërgimit të këtij projektvendimi nga ky i fundit te gjyqtari përkatës.
- iii. Dokumenti ligjor nr. 3 ka pasaktësi për sa i përket strukturës së tij, si dhe orientimit referuar se cilës çështje konkrete i përket.
- iv. Në lidhje me çështjen administrative nr. *** regjistri themeltar, datë 17.11.2015, me paditëse E.D. kundër të paditurve APP-së Tiranë dhe Avokatit të Shtetit, me objekt “kundërshtimi i vendimit administrativ nr. ***, datë 23.10.2015, të APP-së, përfunduar me vendimin nr. ***, datë 22.1.2016”, duket sikur gjyqtari i çështjes ka marrë një vendim bazuar në analizën e tij dhe jo mbi bazën e opinionit ligjor të ndihmësit. Gjithashtu, është e paqartë pse ky opinion ligjor është dërguar 4 ditë pas shpalljes së vendimit dhe nga gjyqtari nuk gjejmë të dokumentuar një reagim për këtë veprim në vonesë, po ashtu e paqartë është edhe rruga se si është përcjellë ky informacion te gjyqtari.

2. Komisioni në lidhje me këtë konstatim ka pyetur subjektin, i cili në përgjigje të tij ka deklaruar se nuk ka dhënë opinion ligjor për këtë çështje, pasi nuk i është kërkuar nga gjyqtari B.K., opinionit ligjor mbi këtë çështje. Nga gjyqtari i çështjes i është kërkuar në formën e ndihmës zbardhja e vendimit, të cilin gjyqtari e kishte marrë në seancën e datës 22.1.2016 dhe kjo zbardhje hartohet në formën e një projektvendimi të cilin gjyqtari e ndryshonte plotësisht ose pjesërisht.

3. Në lidhje me çështjen administrative nr. ***, datë 18.9.2015, që i përket kërkuesit AKBN, me objekt “nxjerrje e urdhrat të ekzekutimit”, përfunduar me vendimin, datë 25.9.2015, konstatohet se kopja e dokumentit që mendohet se është përgatitur nga ndihmësi ligjor është i ndryshëm për sa i përket formatit, por është e njëjtë në pjesën arsyetuese, edhe në këtë rast nuk gjejmë “rrugë” komunikimi ndërmjet gjyqtarit dhe ndihmësit në lidhje me përgatitjen e këtij mendimi. Në rastin në fjalë konstatohet se projektakti i dërguar nga ndihmësi ligjor te gjyqtari i çështjes është dërguar me rrugë elektronike 2 ditë pas shpalljes së vendimit. Në këto kushte duket sikur në këtë rast gjyqtari i çështjes ka marrë një vendim bazuar në analizën e tij dhe jo mbi bazën e opinionit ligjor të ndihmësit dhe nuk gjendet atkërkimi, pranimi dhe as aktrefuzimi nga gjyqtari në lidhje me opinionin ligjor.

4. Subjekti, në përgjigje të tij, ka deklaruar se nuk ka dhënë opinion ligjor për këtë çështje, pasi nuk i është kërkuar nga gjyqtari S.Gj., opinionit ligjor mbi këtë çështje. Nga gjyqtari i çështjes i është kërkuar në formën e ndihmës zbardhja e vendimit, të cilin gjyqtari e kishte marrë në seancën e datës 20.1.2016 dhe kjo zbardhje hartohet në formën e një projektvendimi, të cilin gjyqtari e ndryshonte plotësisht ose pjesërisht.

5. Referuar konstatimeve më lart, Komisioni i kërkoi informacion gjyqtarëve S.Gj. dhe B.K., për të cilët ka punuar subjekti i rivlerësimit, në lidhje me mënyrën e operimit dhe vlerësimin e tyre në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza.

6. Gjyqtari B.K. ka informuar se puna e ndihmësit ligjor nuk është e rregulluar me ndonjë normë ligjore pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjyqtari B.K. vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka cilësi akademike, profesionale, është korrekt dhe i përkushtuar në punë²⁷.

7. Gjyqtarja S.Gj. vlerëson subjektin e rivlerësimit si njohës të mirë të ligjit në studimin e dosjes, si dhe në dhënien e opinionit ligjor. Gjyqtarja S.Gj. thekson se mënyra e ushtrimit të funksionit të ndihmësit ligjor nuk gjeti rregullim në ligj apo në ndonjë akt të veçantë, kështu që secili prej gjyqtarëve kishte mënyrën e vet të komunikimit me ndihmësin për sa i përket vënies në dispozicion të dosjeve dhe asaj që kërkonte të realizonte. Meqenëse nuk kishte një procedurë të shkruar, në shumicën e rasteve opinionin për zgjidhjen e çështjes ishte verbal. Gjyqtare S.Gj. shpreh mendim pozitiv për aftësitë profesionale, gatishmërinë, korrektesën dhe përkushtimin në realizimin e detyrave të ngarkuara, etikën e komunikimit me gjyqtaren dhe sekretaren gjyqësore, që punon pranë saj²⁸.

8. Duke pasur parasysh informacionin e marrë nga gjyqtarët përkatës në lidhje me mënyrën e operimit, Komisioni vlerëson se mospasja e një procedure apo akti ligjor për rregullimin e punës së ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nuk e bën subjektin e rivlerësimit të papërshtatshëm profesionalisht, sipas pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

9. **Në këto kushte, në konkluzion për vlerësimin e aftësive profesionale** – trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

VIII. KONKLUZIONI PËRFUNDIMTAR

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Enkel Peza, ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016.

²⁷ Shkresa nr. *** prot., datë 26.12.2018, e gjyqtar B.K., drejtuar Komisionit.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2018, e gjyqtare S.Gj., drejtuar Komisionit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Hans Kjlstra, dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58, si dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Enkel Peza, ndihmësligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë në datën 6.9.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Suela ZHEGU
Kryesuese

Xhensila PINE
Anëtare

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj